

KQZ-ja akrediton 283
vëzhgues dhe lehtëson
regjistrimin për votim për
personat mbi 80 vjeç I FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



BEDRI HAMZA VIZITON THAÇIN DHE VESELIN: TË FALA NGA HAGA, IU PREMTOVA SE DO T'I GËZOJMË MË 28 DHJETOR



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka vizituar të martën në Hagë ish-krerët e PDK-së, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, një ditë para hapjes zyrtare të fushatës zgjedhore. Hamza ka bërë me dije se i ka gjetur ish-udhëheqësit e Kosovës në gjendje të mirë

shëndetësore dhe me moral të lartë, pavarësisht, siç ka theksuar ai, padrejtësive me të cilat po përballen në këtë proces gjyqësor. Ai ka theksuar se procesi gjyqësor po shkon drejt përfundimit dhe ka shprehur pritjen që epilogu i tij të jetë i drejtë, duke vlerësuar se zvarritjet nuk i shërbejnë askujt

**DRAFT-KONKLUZAT
E BE-së PËR ZGJERIM:
KOSOVËS I KËRKOHE
ASOCIACIONI,
REFORMA DHE
PËRPARIMI NË DIALOG**
F. 5



**28 DHJETORI, MUNDËSIA
E KTHIMIT NË NORMALITET
ME KUSHTETUTSHMËRI E LIGJSHMËRI,
E KTHIMIT TË ALEANCAVE
EURO-ATLANTIKE DHE FUQIZIMIT TË
INTEGRIMEVE MBARËSHOIPTARE** F. 2

Shkruan: Avdullah HOTI, ish kryeministër i Kosovës



AKTUALE



**TRUMPI THOTË SE NJË
MARRËVESHJE PËR UKRAINËN
ËSHTË "MË AFËR SE KURRË"** F. 2

**PARALAJMËROHET BORË PËR
FUNDVIT DHE TEMPERATURA
-20 GRADË CELSIUS NË KOSOVË** F. 6

**SPAK-u I KËRKON KUVENDIT T'IA
HEQË IMUNITETIN BALLUKUT ME
QËLLIM ARRESTIMIN E SAJ** F. 3

EKONOMI



**AKK-ja THIRRJE BIZNESEVE:
TË NDALOHET ÇDO RITJE E
PAJUSTIFIKUAR E ÇMIMEVE GJATË
FESTAVE TË FUNDVITIT** F. 8

**RITJE E LEHTË E SASISË
SË MBETURINAVE INDUSTRIALE
NË 2024** F. 8

SPORT



**PRESIDENTI I FFK-së DHE AI I FIFA-s
DISKUTOJNË PËR ZHVILLIMIN
E FUTBOLLIT NË KOSOVË** F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI THOTË SE NJË MARRËVESHJE PËR UKRAINËN ËSHTË “MË AFËR SE KURRË”

UASHINGTON, 16 DHJETOR - Zyratë amerikane dhe ata ukrainas kanë thënë se kanë arritur përparim të konsiderueshëm në ditën e dytë të bisedimeve të zhvilluara më 15 dhjetor, me qëllim të përfundimit të luftës së nisur nga Rusia në tokën ukrainase, teksa Uashingtoni raportohet t'i ketë ofruar Kievit garanci të sigurisë të modelit të Artikullit 5 të NATO-s.

Ndonëse ende ka pikëpyetje për çështje me rëndësi, përfshirë fatin e territorit që Kiev vazhdon ta kontrollojë në rajonin lindor Donjeck, presidenti amerikan, Donald Trump ka thënë se duket që një marrëveshje për t'i dhënë fund konfliktit më të madh dhe më vdekjeprurës në Evropë prej Luftës së Dytë Botërore është më afër se kurrë. “Po përpiqemi ta finalizojmë, besoj se jemi më afër tani”, u ka thënë Trump gazetarëve në Zyrën Ovale më 15 dhjetor pasi delegacionet amerikane, evropiane dhe ukrainase kanë zhvilluar disa ditë negociata në Berlin. “Kemi zhvilluar disa biseda me presidentin [rus, Vladimir] Putin të Rusisë dhe besoj se jemi më afër se kurrë dhe të shohim se çfarë mund të bëjmë”.

Trump e ka përmendur se ka biseduar së fundmi me

presidentin rus, por nuk ka dhënë më shumë hollësi. Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky ka thënë se bisedimet kanë qenë të vështira, por të dobishme dhe që shefi i tij negociator, Rustem Umerov ka thënë se ka pasur “përparim real” në Berlin me të dërguarin e posaçëm të Shtëpisë së Bardhë, Steve Witkoff dhe Jared Kushnerin, dhëndrin e presidentit amerikan Donald Trump, që kanë qenë pjesë e delegacionit amerikan. “Këto biseda nuk janë gjithmonë të lehta, do të jem i sqartë me ju. Por ka qenë bisedë produktive, me shumë hollësi, me të vërtetë shumë”, ka thënë Zelensky në një forum biznesor gjermano-ukrainas që është mbajtur pas takimit ShBA-Ukrainë.

Në një konferencë për media të zhvilluar më vonë nga kancelari gjerman, Friedrich Merz, Zelensky ka thënë se palët “kanë dallime” sa u përket territoreve, dhe që çështja “nuk është mbyllur”. “Çështja territoriale është e dhimbshme. Ne e dimë 100 për qind çfarë dëshiron Rusia, dhe është shumë me rëndësi që amerikanët më kanë dëgjuar në këtë drejtim”, ka thënë Zelensky. “Unë besoj që amerikanët, si ndërmjetësues, do të analizojnë mënyra të



ndryshme si t'i zgjidhin këto çështje”, përfshirë territorin dhe ndarjen e fondeve për rindërtim të Ukrainës. Zelensky i ka refuzuar propozimet që kërkojnë nga Kiev të heqë dorë nga një pjesë e rajonit të Donjeckut, që ende e ka nën kontroll. Dhe ai ka sugjeruar që nëse Ukraina duhet të largohet nga vija e frontit në Donbas, atëherë edhe forcat ruse duhet të veprojnë njëjtë. Rusia, në anën tjetër, insiston në koncesione territoriale, duke kërkuar gjithë rajonin ukrainas të Donbasit. Nëse nuk ndodh ashtu, Putini ka thënë se rusët do ta marrin atë rajon me forcë. Kancelari Merz ka thënë se tani

është shansi më i madh për proces të paqes prej nisjes së luftës në shkurt të vitit 2022 dhe që Shtetet e Bashkuara kanë bërë kontribut të madh për garanci të sigurisë për Ukrainën. Një grup prej shtatë shteteve të Bashkimit Evropian, liderët e BE-së dhe Zelensky e kanë publikuar një deklaratë të përbashkët duke thënë se mbështesin një ushtri ukrainase prej 800.000 trupash, një forcë multikombëtare të udhëhequr nga evropianët dhe një mekanizëm të udhëhequr nga amerikanët për monitorim dhe verifikim për të zbatuar një armëpushim eventual. Ndërkohë, shumë agjenci të lajmeve i kanë cituar zyrtarët

amerikanë të kenë thënë se propozimet e diskutuara në Berlin i ngjasojnë Artikullit 5 të NATO-s. Ky artikull parasheh që sulmi ndaj një vendi anëtar konsiderohet sulm ndaj të gjitha vendeve anëtare të aleancës. Uashingtoni nuk ka dhënë hollësi se si do t'i ofrojë garancitë e sigurisë, ndonëse ka pasur zyrtarë që kanë thënë se një ofertë e tillë nuk do të jetë përgjithmonë në tavolinë. Zëdhënësi i Putinit, Dmitry Peskov ka thënë më 15 dhjetor se heqja dorë e Ukrainës nga anëtarësimi në NATO është “gurthemel” për një marrëveshje për paqe në sytë e Kremlinit, dhe që Rusia prej të dëgjojë nga zyrtarët amerikanë se çfarë është diskutuar në Berlin, pasi Moska nuk ka qenë e përfshirë. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus, Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për të çmilitarizuar Ukrainën. Përfundimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

MALI I ZI MBYLL EDHE PESË KAPITUJ NË NEGOCIATAT ME BE-NË

PODGORICË, 16 DHJETOR - Komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos, deklaroi më 16 dhjetor në Bruksel se Mali i Zi kurrë nuk ka qenë më afër Bashkimit Evropian (BE). Ajo e tha këtë pasi Mali i Zi, në Konferencën Ndërqeveritare me BE-në të martën, mbylli pesë kapituj negociues në procesin e anëtarësimit në bllokun evropian. Bëhet fjalë për kapitujt: 3 - Liria e lëvizjes së kapitalit dhe e ofrimit të shërbimeve; 4 - Liria e lëvizjes së kapitalit; 6 - Ligji për tregti; 11 - Bujqësia dhe zhvillimi rural dhe 13 - Peshkimi. Kos përsëriti qëndrimin se Mali i Zi është udhëheqësi i procesit të integritetit dhe kandidati me rezultatet më të mira, gjë që, sipas saj, “u dëshmuua sot me 12 kapituj të mbyllur” nga gjithsej 33. “Por, duhet të jemi të sqartë: pjesa më e vështirë ende është përpara, sepse Mali i Zi ka njoftuar se dëshiron t'i përfundojë negociatat deri në fund të vitit 2026, dhe



Komisioni Evropian ju mbështet. Për ta arritur këtë, duhet të vraponi shpejt”, tha Kos. Zyrtarja e lartë evropiane theksoi se Mali i Zi tani duhet t'i përshpejtojë reformat. “Çelësi do të jenë reformat në sundimin e ligjit. Prioritet janë

emërimet, për të siguruar një gjyqësor të pavarur, ku gjyqtarët mund të marrin vendime lirshëm dhe pa presion politik. Kjo nënkupton gjithashtu vazhdimin e luftës së fortë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në mënyrë që askush të mos jetë mbi

ligjin”, tha Kos. Ajo përsëriti se Podgorica do ta ketë mbështetjen e BE-së “në çdo hap”. “Viti i ardhshëm do të jetë vendimtar dhe më shumë se kurrë Malit të Zi i nevojitet unitet kombëtar për të arritur qëllimin. Viti i ardhshëm mund të jetë edhe më i mirë”, u shpreh ajo. Kryeministri Millojko Spajiq deklaroi se Mali i Zi ka mbyllur më shumë se një të tretën e kapitujve në negociatat për anëtarësim në BE, duke e cilësuar këtë si një sukses të madh. Ai tha se BE-ja me Malin të Zi po fiton një anëtar të aftë të ecë krah për krah me disa shtete anëtare, edhe pse dikur ishte republika më e varfër e ish-Jugosllavisë. “Mali i Zi nuk do të jetë një barrë të madhe tatimore për qytetarët e BE-së”. Sipas tij, çdo ditë po dëshmohej se është një qëllim realist që Mali i Zi t'i mbyllë të gjitha kapitujt deri në fund të vitit 2026. “Ne po krijojmë kushtet që t'i përmbushim të

gjitha deri në fund të vitit të ardhshëm”, tha Spajiq. Nga Qeveria e Malit të Zi më herët kanë përsëritur disa herë plani që 21 kapitujt e mbetur të mbyllen gjatë vitit 2026, në mënyrë që shteti të anëtarësohet në BE më 2028. Më herët nga Qeveria ishte bërë e ditur se janë përmbushur të gjitha kushtet për mbylljen e Kapitullit 31, i cili lidhet me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes, por vendimi për mbylljen e tij ishte shtyrë më herët me kërkesë të Kroacisë. Kroacia bllokoi mbylljen e këtij kapitulli pasi Kuvendi i Malit të Zi në vitin 2024 miratoi Rezolutën për gjenocidin në Jasenovac, me iniciativë të partive proruse dhe proserbe në shumicën qeverisëse, lider i të cilave është kryetari aktual i parlamentit, Andrija Mandiq, çka Zagrebi zyrtar e vlerësoi si provokim. Mali i Zi i ka nisur negociatat për anëtarësim në BE në qershor të vitit 2012.

BEDRI HAMZA VIZITON THAÇIN DHE VESELIN: TË FALA NGA HAGA, IU PREMTOVA SE DO T'I GËZOJMË MË 28 DHJETOR

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka vizituar të martën në Hagë ish-krerët e PDK-së, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, një ditë para hapjes zyrtare të fushatës zgjedhore. Në një postim në "Facebook", Hamza ka bërë me dije se i ka gjetur ish-udhëheqësit e Kosovës në gjendje të mirë shëndetësore dhe me moral të lartë, pavarësisht, siç ka theksuar ai, padrejtësive me të cilat po përballen në këtë proces gjyqësor. "Muret në Hagë nuk mund ta burgosin të vërtetën dhe idealin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe shokëve të tyre. Ata i shërbyen Kosovës me sakrificë dhe sot qëndrojnë të fortë, me kokën

lart", ka shkruar Hamza.

Ai ka theksuar se procesi gjyqësor po shkon drejt përfundimit dhe ka shprehur pritjen që epilogu i tij të jetë i drejtë, duke vlerësuar se zvarritjet nuk i shërbejnë askujt. "Si qytetar i Kosovës, si mik, si kryetar i PDK-së dhe kandidat për kryeministër, i ndiej personalisht këto padrejtësi. Zvarritjet nuk i shërbejnë askujt: as drejtësisë, as Kosovës dhe as bashkësisë ndërkombëtare", ka theksuar Hamza.

Në fund të mesazhit të tij, Hamza ka deklaruar se Kosova po i pret bijtë e saj me krenari dhe ka përsëritur bindjen se liria dhe drejtësia do të triumfojnë.

"Liria ka emrat e tyre dhe ata po rikthehen në shtëpi", ka përfunduar Hamza, duke shtuar se nga Haga u ka premtuar se do të gëzojnë bashkë më 28 dhjetor.



SPAK-u I KËRKON KUVENDIT T'IA HEQË IMUNITETIN BALLUKUT ME QËLLIM ARRESTIMIN E SAJ

TIRANË, 16 DHJETOR - Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) i ka kërkuar Kuvendit të Shqipërisë që të heqë imunitetin zëvendëskryeministres Belinda Balluku dhe të autorizojë arrestimin e saj.

Ndaj Ballukut, e cila njëherësh është edhe deputete dhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, SPAK-u ka ngritur aktakuzë më 31 tetor të këtij viti, nën dyshimet se ka bërë shkelje gjatë dhënies së tenderëve.

Ajo ishte pezulluar nga detyrat zyrtare dhe i ishte pamundësuar largimi nga shteti, por vendimi i SPAK-ut për pezullim u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se pas vendimit të Kushtetueses, tani SPAK-u po kërkon autorizim për



arrestimin e Ballukut, qoftë për ta dërguar në burg apo në arrest shtëpiak.

Ai tha se "arrestet pa gjyq" janë bërë "modë e vrazhdë në Shqipëri", por shtoi se nuk mund ta paragjykojë kërkesën në fjalë. "Por, sigurisht që në rastin në fjalë, ne s'mund dhe s'do ta paragjykojmë kërkesën e prokurorit special, por duke

qenë se ndryshe nga proceset e tjera, ku ne si rregull s'flasin për përmbajtjen e çështjeve, këtë herë na kërkohet të japim opinionin tonë, ne do të angazhohemi me të gjithë përgjegjësinë tonë përpara shqiptarëve që na dhanë 83 mandate, e do të përgatitemi për të mbajtur një qëndrim të drejtë, të qartë e të denjë, si

forca udhëheqëse e vendit dhe e reformës në drejtësi", shkroi ai në X.

SPAK e akuzon Ballukun për veprën penale: "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike", përkatësisht për ndërtimin e tunelit të Llogarasë.

Ajo po ashtu po hetohet nën dyshimet se ka kryer të njëjtën veprë penale në shtatë procedura të tjera prokurimi, përfshirë edhe për ndërtimin e Unazës së Jashtme të Tiranës.

Sa i përket ndërtimit të tunelit të Llogarasë, SPAK më herët kishte njoftuar se ishin evidentuar veprime të kundërligjshme të bëra nga Balluku. "Në cilësinë e ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë ka ndjekur dhe orientuar në vijimësi procedurën e këtij prokurimi publik, prej fazës përgatitore,

zhvillimit të procedurës, dorëzimit dhe vlerësimit të ofertave, deri në momentin e lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues", ka thënë SPAK më 20 nëntor.

Edhe për Unazën e Jashtme ajo dyshohet se ka orientuar procedurën e prokurimit publik. SPAK është krijuar në dhjetor të vitit 2019, pas ndryshimeve kushtetuese që u votuan më 2016. Kjo strukturë ka hetuar disa ish-zyrtarë, ish-ministra e deputetë, të cilët janë duke e vuajtur dënimin.

Ky organ ka kryer hetime kundër korrupsionit ndaj figurave të larta, sikurse ish-presidenti Ilir Meta dhe ish-kryeministri Sali Berisha. Berisha është liruar nga arresti shtëpiak në fund të nëntorit të vitit të kaluar, ndërsa Meta gjendet në paraburgim.

Policia nis hetime pas dyshimeve për dhunim të një të mituri

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Policia e Kosovës njoftoi të martën se ka nisur hetimet për veprën penale të "dhunimit", pas dyshimeve për abuzimin e një të mituri.

Policia ka thënë se më 15 dhjetor e ka pranuar një informacion në stacionin në Fushë Kosovë për dyshimet se një i mitur është dhunuar.

Sipas njoftimit, institucioni po punon në identifikimin e të dyshuarit, dhe nuk ka ofruar më shumë hollësi për rastin.

Sipas autoriteteve të sigurisë, dyshimet sugjerojnë se i mituri ishte kontaktuar përmes rrjeteve sociale dhe ngjarja dyshohet të ketë ndodhur diku në territorin e Ferizajt. "Specialistë të policisë për hetimin e rasteve të tilla, në bashkëpunim me institucionet relevante, janë duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbardhjen e plotë të rastit", u tha në njoftim.

Ndërkaq, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë

konfirmuan për "Radion Evropa e Lirë" se prokurori i rastit është në fazën preliminare të çështjes dhe ka nisur mbledhjen e të gjitha informacioneve për këtë rast. "Nuk mund të japin informacione të tjera sepse rasti ka të bëjë me të mitur dhe duhet të ruhet konfidencialiteti për mbrojtjen e të miturve", tha zëdhënësjja e Prokurorisë, Kaltrina Shala.

Më 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte dënuar me

dyzet vjet burgim katër të akuzuar për dhunimin e një 11-vjeçareje në Prishtinë. Ky rast kishte nxitur reagim në shoqëri, kur u mbajtën edhe protesta për të kërkuar "dënim meritore" për të dyshuarit.

Kodi Penal i Kosovës parasheh dënime deri në dhjetë vjet burgim për veprën penale të dhunimit.

Sipas Kodit, kushdo që e detyron një person tjetër të kryejë akt seksual pa pëlqimin e tij mund të dënohet nga dy deri



në dhjetë vjet burgim.

Ndërkaq, nga tre deri në dhjetë vjet burgim mund të dënohet kushdo që e detyron dikë tjetër të kryejë akt seksual duke e kanosur përmes zbulimit të një fakti që do ta "dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e personi apo një personi të lidhur ngushtë me të".

DRAFT-KONKLUZAT E BE-së PËR ZGJERIM: KOSOVËS I KËRKOHET ASOCIACIONI, REFORMA DHE PËRPARIMI NË DIALOG

Këshilli për Çështje të Përgjithshme i Bashkimit Evropian miraton të martën konkluzionet sa i përket procesit të zgjerimit të bllokut evropian. Në pjesën për Kosovën, vendit i bëhet thirrje që ta përshpejtojë hapin në rrugën drejt reformave. Ndër kërkesat tjera është zbatimi i marrëveshjeve të arritura me Serbinë, në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve, përfshirë nevojën e formimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Këshilli për Çështje të Përgjithshme i Bashkimit Evropian miraton të martën konkluzionet sa i përket procesit të zgjerimit të bllokut evropian, ndërsa në pjesën për Kosovën, vendit i bëhet thirrje që ta përshpejtojë hapin në rrugën drejt reformave.

Ndër kërkesat tjera është zbatimi i marrëveshjeve të arritura me Serbinë, në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve, përfshirë nevojën e formimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Kosova është e vetmja në Ballkanin Perëndimor që nuk e gëzon statusin e vendit kandidat për anëtarësim, ndonëse ka aplikuar në dhjetor të vitit 2022.

Në raportin me draft-konkluzat që e ka siguruar Radio Evropa e Lirë, përmendet se nevoja për reforma vërehet më së shumti në forcim të administratës publike dhe sundim të ligjit, përfshirë konsolidimin e sistemit gjyqësor, luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e lirive themelore, sidomos lirinë e shprehjes, sektor në të cilin nuk është shënuar përparim.

Përparim thuhet të ketë pasur në luftën kundër krimit të organizuar.

Kosova lavdërohet për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme të shkurtit dhe më pas ato lokale më vonë

gjatë vitit, marrë parasysh pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në to.

Lidhur me këtë, në draftin e konkluzave përmendet që marrë parasysh transferimin e rregullt të pushtetit në katër komunat me shumicë serbe në veri të vendit, Këshilli përsërit dhe pret heqjen e të gjitha masave ndëshkuese që kanë mbetur.

Bashkimi Evropian pati vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës në verën e vitit 2023, si pasojë e tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe.

Blloku evropian ka nisur heqjen graduale të tyre, por zyrtarët në Kosovë insistojnë se vazhdimi i tyre është vendim i padrejtë, meqë të gjitha kërkesat për heqjen e tyre tashmë janë plotësuar.

Në mesin e tyre situata në veri është shtensionuar, prania e Policisë afër objekteve komunale në veri është zvogëluar dhe kalimi paqësor i pushtetit në komunat me shumicë serbe është realizuar. Rikard Jozwiak, redaktor për Evropën i Radios Evropa e Lirë (REL), në Pragë, ka marrë vesh nga burimet e tij se për çështjen e moslargimit të të gjitha masave kundër Kosovës është diskutuar në Bruksel javën e kaluar dhe që Franca e Italia janë mbështetëse të idesë që të largohen vetëm 50 për qind e tyre.

Por, duket se përparim në këtë drejtim nuk do të ketë para



zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit në Kosovë.

Sipas një analize të Institutit për Studime të Avancuara - GAP, masat e BE-së i kanë kushtuar Kosovës rreth 613.4 milionë euro në projekte të pezulluara ose të shtyra për afat të pacaktuar. Për shkak të kalimit të afateve, 7.1 milionë euro janë humbur tërësisht.

Në raport, BE-ja përmend se procesi i zgjerimit ka rëndësi gjeostrategjike dhe është proces që kontribuon në paqen evropiane, sigurinë dhe stabilitetin e shekullit 21. Këshilli u bën thirrje të gjithë partnerëve që ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe këtë momentum për t'i marrë të gjithë hapat e nevojshëm për ta përshpejtuar përparimin në rrugën drejt BE-së.

Përveç përgatitjeve të nevojshme nga ana e vendeve kandidate, në raport përmendet edhe nevoja e përgatitjeve të vetë bllokut për të akomoduar anëtarë të rinj.

Sa u përket vendeve të

Ballkanit, përmendet rëndësia e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal. “Këshilli inkurajon fuqishëm partnerët që t'i zgjidhin të gjitha mospajtimet bilaterale dhe çështjet që datojnë prej së kaluarës, në linjë me ligjin ndërkombëtar”, përmendet mes tjerash në raport.

Pritjet për dialogun Kosovë - Serbi

Në raportin me draft-konkluzat, Këshilli përmend mbështetjen e plotë për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Aty përmendet që të dyja palët mund të humbin mundësi të mëdha në mungesë të përparimit në normalizim.

Kosova dhe Serbia dialogojnë në Bruksel prej vitit 2011, i kanë arritur disa marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar. “Përparimi në rrugët e tyre respektive evropiane varet nga përpjekjet për t'i zbatuar

plotësisht të gjitha zotimet që dalin nga Marrëveshja për normalizim e vitit 2023 dhe të gjitha marrëveshjet tjera, pa vonesa dhe parakushte”.

Mes tjerash përmendet edhe nevoja që Kosova të zbatojë marrëveshjen për themelim të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, dhe të veprojë në përputhje me zotimet për “një nivel të përshtatshëm të vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë” në përputhje me Nenin 7, siç e parasheh Marrëveshja për normalizim dhe aneksi i saj.

Pritje ka që edhe çështja e strukturave të mbështetura nga Serbia, përfshirë ato të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe edukimit, të zgjidhen në përputhje me zotimet e dialogut dhe të punohet në riintegrim të serbëve të Kosovës, nisur prej pjesëmarrjes së tyre në të gjitha nivelet institucionale. Në një rën pikë të draft-konkluzave, në pjesën për Kosovën, vendi duartrokitet që është në linjë me politikën e Jashtme të BE-së, duke dënuar luftën e Rusisë në Ukrainë.

Abdixhiku i dërgon letër presidentes së KE-së, kërkon heqjen e masave të BE-së ndaj Kosovës

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka njoftuar se kryetari Lumir Abdixhiku, i ka shkruar presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ku ka kërkuar heqjen e menjëhershme të masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian (BE) ndaj Republikës së Kosovës. “Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kërkon heqjen e menjëhershme të masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Republikës së

Kosovës. LDK-ja vlerëson se vazhdimi i këtyre masave është i pajustifikuar dhe nuk pasqyron zhvillimet aktuale politike dhe institucionale në vend. Masat e Bashkimit Evropian po prodhojnë pasojat e drejtpërdrejta për qytetarët e Kosovës dhe po dëmtojnë institucionet e shtetit. Pushteti lokal në Republikën e Kosovës në komunat veriore tashmë është transferuar dhe është plotësuar kriteri i vendosur nga BE-ja”, ka njoftuar LDK-ja. Sipas LDK-së, këto masa kanë



dëmtuar drejtpërdrejt Kosovën dhe qytetarët e saj, e jo politikanët. “Si pasojë, një numër

i konsiderueshëm projektsh zhvillimore dhe investimesh të rëndësishme kanë mbetur të

bllokuara dhe të parealizuara, duke penguar zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Lidhja Demokratike e Kosovës i bën thirrje Bashkimit Evropian që të marrë vendim për heqjen e plotë të masave ndëshkuese ndaj Republikës së Kosovës, në përputhje me parimet e drejtësisë, proporcionalitetit dhe partneritetit. Republika e Kosovës meriton trajtim të drejtë dhe mbështetje konkrete në rrugëtimin e saj evropian!”, ka njoftuar LDK-ja.

AIP U BËN THIRRJE PARTIVE POLITIKE TË RESPEKTOJNË MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Me fillimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 dhjetor 2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) ka ritheksuar kërkesën ndaj partive politike për respektimin e plotë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë procesit zgjedhor.

Në njoftimin e saj, AIP thekson se “aktivitetet e përpunimit të të dhënave personale gjatë fushatës zgjedhore duhet të realizohen në pajtim të plotë me udhëzimet e Agjencisë që rregullojnë komunikimin me votuesit”, duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia ka kërkuar nga subjektet politike që përpunimi i të dhënave personale për qëllime të promovimit të kandidatëve, komunikimit me votuesit apo organizimit të aktiviteteve



politike të bëhet “mbi baza të qarta ligjore, duke respektuar parimin e drejtësisë, proporcionalitetit dhe transparencës”. Sipas AIP-së, subjektet politike mbajnë përgjegjësi të plotë për sigurinë dhe ligjshmërinë e përpunimit të

të dhënave personale të qytetarëve. Në këtë drejtim, Agjencia ka theksuar se “çdo përpunim i të dhënave personale duhet të mbështetet në një bazë ligjore, siç është pëlqimi i qytetarëve, interesi legjitim i subjektit politik apo arsye të tjera të

përcaktuara me ligj”. Po ashtu, AIP ka paralajmëruar se të dhënat e kontaktit të qytetarëve, të mbledhura gjatë ushtrimit të funksioneve publike apo për qëllime jo-politike, nuk duhet të përdoren për komunikim apo marketing politik.

Në njoftim theksohet edhe e drejta e qytetarëve për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave të tyre. “Subjektet politike janë të obliguara të ndërpresin menjëherë komunikimin pas paraqitjes së kundërshtimit nga qytetarët”, thuhet në njoftim. Agjencia ka kërkuar gjithashtu shmangien e profilizimit të votuesve dhe përpunimit masiv të të dhënave të ndjeshme për qëllime të marketingut politik, përveç rasteve kur ekziston bazë e qartë ligjore. “Në rastet kur përdoren teknologji që paraqesin rrezik të lartë për të drejtat e individëve, kërkohet kryerja e Vlerësimit të Ndikimit mbi Mbrojtjen e të Dhënave”, thuhet në njoftim. Në fund, AIP ka bërë të ditur se do të ofrojë mbështetje profesionale për subjektet politike, duke theksuar se qëllimi është që “procesi zgjedhor të zhvillohet në përputhje me standardet më të larta për mbrojtjen e të dhënave personale”.



KQZ-ja AKREDITON 283 VËZHgues DHE LEHTËSON REGJISTRIMIN PËR VOTIM PËR PERSONAT MBI 80 VJEÇ

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur mbledhjen e 100 në këtë vit, të kryesuar nga kryesuesi Kreshnik Radoniqi. Në fillim të mbledhjes, KQZ-ja ka marrë vendim për akreditimin e grupit të parë me 283 vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025.

Periodha e aplikimit për akreditim të vëzhguesve, e cila ka filluar më 5 dhjetor, do të përfundojë më 20 dhjetor 2025. Gjatë kësaj periudhe 16-ditore, subjektet politike të certifikuara, OJQ-të, organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mediat si dhe përfaqësuesit e

vendeve të huaja, mund të dorëzojnë online kërkesën e tyre për akreditimin e vëzhguesve. Në vazhdim të mbledhjes, KQZ-ja ka marrë vendim sipas të cilit, qytetarët me të drejtë vote mbi 80 vjeç, të cilët aplikojnë për regjistrim si votues me nevoja të veçanta për të votuar përmes ekipeve mobile në ditën e zgjedhjeve, nuk kanë nevojë të paraqesin/bashkëngjisin

certifikatën e paaftësisë apo diagnozës mjekësore. Sipas ndryshimit të bërë, regjistrimi mund të bëhet vetëm duke paraqitur dokumentin e vlefshëm të identifikimit dhe fotografinë e votuesit duke mbajtur në dorë dokumentin identifikues. Duke u mbështetur në të dhënat nga lista votuese e certifikuar nga KQZ-ja, numri i qytetarëve me të drejtë vote mbi 80 vjeç

është 48 mijë e 977 votues. Në vazhdim të mbledhjes, KQZ-ja ka marrë edhe këto vendime: Vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të komunës së Hanit të Elezit; dhe vendim për miratimin e plotësimit të planit të rekrutimit të stafit të përkohshëm për organizim të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 28 dhjetor 2025.

Kryetari Faton Peci themelon Komisionin për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore

Mitrovicë, 16 dhjetor - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faton Peci, të martën ka marrë vendim për themelimin e Komisionit për Identifikimin e Nevojave për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore, si një nga vendimet

e para të mandatit të tij. Me këtë vendim, kryetari Faton Peci, thekson përkushtimin e tij institucional për krijimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, ku çdo fëmijë trajtohet me dinjitet dhe merr

mbështetjen e nevojshme. Komisioni do të ketë rol kyç në identifikimin e saktë dhe profesional të nevojave të nxënësve, me fokus të veçantë tek fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe ata me nevoja të veçanta

arsimore. Komuna e Mitrovicës, nën udhëheqjen e kryetarit, Faton Peci, do të vazhdojë të ndër marrë hapa konkretë për përmirësimin e kushteve arsimore dhe sociale për të gjithë fëmijët, pa përjashtim.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS OFRON MUNDËSI TË REJA PUNËSIMI, SHPALL KONKURS PËR EMËRIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Universiteti i Prishtinës ka shpallur konkurs për emërimin e 42 mësimdhënësve dhe 48 asistentëve në dhjetë njësi akademike. Konkursi është hapur fillimisht për Fakultetin e Filologjisë, Fakultetin Juridik, Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Fakultetin e Arteve, Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, Fakultetin e Edukimit,

Fakultetin e Arkitekturës dhe Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore. Kandidatët që aplikojnë për këto pozita duhet të plotësojnë kërkesën për aplikim, të kenë të përgatitur CV-në e plotë me të gjitha arritjet akademike, diplomat e të gjitha niveleve të studimit, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale dhe dëshmitë për përvojën mësimdhënëse në institucionet e arsimit të lartë. Ata gjithashtu këtyre dokumenteve duhet t'ua bashkohen edhe dëshminë nga gjykata themelore që nuk janë të dënuar dhe certifikatën e

lindjes. UP-ja ka njoftuar se është duke u përgatitur dhe së shpejti do të shpallë konkurs për personelin akademik edhe në njësi tjera, të cilat ende nuk është arritur të përfshihen në konkursin aktual. Universiteti i Prishtinës siguron të gjithë aplikantët se emërimi do të bëhet në mënyrë meritore, në përputhje me të gjitha normat dhe procedurat e përcaktuara dhe duke u bazuar në ligjshmëri e në meritokraci, pa përjashtim. “Universiteti më i madh, më i vjetër dhe më i suksesshëm i Kosovës dhe i rendituri më së larti në platformat prestigjioze



ndërkombëtare nga të gjitha universitetet në gjuhën shqipe të hapësirave ku jetojnë shqiptarët, është punëdhënësi i drejtë, i përgjegjshëm dhe

gjithnjë mëton të veprojë me transparencë e meritokraci duke përzgjedhur aplikantët më meritore”, ka njoftuar UP-ja.

PARALAJMËROHET BORË PËR FUNDVIT DHE TEMPERATURA -20 GRADË CELSIUS NË KOSOVË



PRISHTINË, 16 DHJETOR - Nën ndikimin e vazhdueshëm të presionit të lartë atmosferik, vendi ynë do të përballet edhe në ditët në vijim me mjegull të dendur dhe persistente, e cila pritet të reduktojë ndjeshëm dukshmërinë, sidomos gjatë orëve të mëngjesit dhe mbrëmjes. Menaxheri i departamentit

meteorologjik në KANS, Sherif Gosalcit, ka thënë se sipas parashikimeve aktuale, moti do të nisë të ndryshojë në pjesën e dytë të javës që vjen, kur pritet një depërtim i masave të ftohta ajrore. Ky ndryshim do të shoqërohet me reshje bore në shumë zona të vendit, duke krijuar kushte për një fundvit të bardhë.

Sipas Gosalcit, zhvillimet aktuale preliminare sinjalizojnë edhe një valë të fortë acari, me rënie të ndjeshme të temperaturave. Në disa rajone, termometri mund të zbresë deri në -20°C, duke sjellë temperatura me karakteristika polare. “Nën ndikimin e presionit të lartë atmosferik, mjegulla do të vazhdojë edhe ditëve në vijim

të jetë persistente në vendin tonë dhe më gjerë. Mot i ndryshueshëm dhe me reshje bore pritet në pjesën e dytë të javës që vjen. Zhvillimet aktuale preliminare, na paralajmërojnë për një ndërrim të motmoteve me reshje bore dhe acar që mund të përshkohet me temperatura polare edhe deri - 20°C!”, ka shkruar Gosalcit në “Facebook”.

MË PAK LINDJE NË TETOR 2025 SESA NË SHTATOR 2025

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat preliminare[1] në baza mujore për lindjet, vdekjet, kurorëzimet dhe shkurorëzimet për muajin tetor 2025. Në muajin tetor 2025 janë regjistruar 2 269 lindje (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej këtyre lindjeve të

regjistruara 1 163 lindje janë meshkuj dhe 1 106 lindje janë femra. Në muajin tetor 2025 pati rënie të numrit të lindjeve për 9,6%, krahasuar me muajin shtator 2025. Gjatë muajit tetor 2025 janë regjistruar gjithsej 889 raste të vdekjeve (brenda dhe jashtë Kosovës). Nga gjithsej vdekje të regjistruara, 471 janë meshkuj dhe 418 janë

femra. Krahasuar me muajin shtator 2025, në muajin tetor janë regjistruar më pak raste të vdekjeve për 2,2%. Në muajin tetor 2025 janë regjistruar gjithsej 1 261 kurorëzime (brenda dhe jashtë Kosovës). Krahasuar me muajin shtator 2025, në muajin tetor ka rritje të numrit të kurorëzimeve për rreth 2,2%.

Kurse, në këtë periudhë janë regjistruar 158 raste të shkurorëzimeve në Kosovë. Krahasuar me muajin shtator 2025 ka rritje të numrit të shkurorëzimeve për 18,8%. Këto të dhëna publikohen duke u bazuar në të dhëna administrative. Burimi i të dhënave të këtij publikimi është Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës (ARC).



Smajl Latifi riemëron shef të kabinetit Ardit Halilajn

PRISHTINË, 16 DHJETOR - “Sot, riemërova shefin e kabinetit, Ardit Halilaj”, kështu ka njoftuar në “Facebook” kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi.

Ai ka bërë me dije se gjatë mandatit të kaluar, Halilaj ka dëshmuar përkushtim të lartë, qasje unifikuese mes Kabinetit dhe Administratës Komonale dhe suksese në

detyrat që i janë besuar, duke kontribuar në punën e përditshme të institucionit dhe shërbimin ndaj qytetarëve. “I uroj suksese të mëtejshme në mandatin e ri

dhe jam i bindur që do të vazhdojë të punojë me të njëjtin profesionalizëm dhe me përgjegjësi për të mirën e komunës së Rahovecit”, ka shkruar kryetari Latifi.



28 DHJETORI, MUNDËSIA E KTHIMIT NË NORMALITET ME KUSHTETUTSHMËRI E LIGJSHMËRI, E KTHIMIT TË ALEANCave EURO-ATLANTIKE DHE FUQIZIMIT TË INTEGRIMEVE MBARËSHQIPTARE



Shkruan: Avdullah HOTI,
ish kryeministër i Kosovës

1. Katër vitet e fundit janë karakterizuar me qeverisje kaotike dhe mashtruese, të shoqëruara me shkelje të vazhdueshme ligjore e kushtetuese, korrupsion të thellë dhe abuzim flagrant me pushtetin. Vetëngulë në drejtësi, reformat në arsim e shëndetësi, energjia dhe shumë çështje të tjera të premtuara u dëshmuar se kanë qenë mashtrime elektorale. Menaxhimi i krizës energjetike dhe i inflacionit që pasoi ishte kaotik. Disa herë u zgjat situata emergjente në energjetikë përmes vendimeve të Kuvendit të Kosovës, por asgjë konkrete nuk ndodhi.

Kaosi ka kapluar institucionet gjithandej për shkak të procesit të bashkimit të disa ministrive. Shumica e pozitive drejtuese nëpër ministri funksionojnë me ushtrues detyre jashtë çdo afati ligjor. Shumë zyrtarë kanë mbetur të pasistemuar, siç kërkohet me ligj. Në shumë raste, përmes vendimeve të organeve kompetente është dëshmuar se shkakimet e zyrtarëve të lartë janë bërë në mënyrë joligjore. Ndërhijet në emërimet në pozita të larta janë të paprecedenta. Shumë ambasada janë pa staf të kompletuar.

Si asnjëherë më parë, mbi dhjetë ligje dhe vendime të Kuvendit janë shpallur jokushtetuese. Ata që i kanë miratuar këto ligje, në vend që të reflektonin, kanë insistuar në shkeljet e tyre. Shkeljet vazhduar edhe me mbi 50 seanca jokushtetuese në procesin e konstituimit të Kuvendit.

Qeverisja u shoqërua me afëra korruptive dhe abuzime të hapura nga zyrtarë të lartë, tashmë nën hetim nga drejtësi.

2. Ekonomia e rënduar, me kosto të rritura të prodhimit dhe shportë shumë më të shtrenjta të konsumit Rreth 14 miliardë euro janë shpenzuar në vitet 2021-2025, por efektet nuk vërehen askund. Ekonomisë i mungojnë qindra miliona euro për shkak të mosrealizimit të kontratave dhe shpenzimeve shumë të ulëta për investime kapitale. Shumë kompani private sot janë në vështirësi financiare si rezultat i rënies së aktivitetit të sektorit publik sa i përket investimeve kapitale, duke prodhuar efekte ekonomike dhe sociale negative në mbarë ekonominë.

Edhe ato investime kapitale që janë bërë, në shumë raste janë realizuar përmes tenderëve njëburimorë. Një praktikë e tillë, në

shumicën dërmuese të rasteve, bie në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit, pasi tri kushtet bazike të këtij ligji për nënshkrimin e kontratave njëburimorë nuk plotësohen. Për më tepër, sa herë që nënshkruhet një kontratë njëburimorë, nuk dihet nëse investimi publik po realizohet me çmimin më të ulët të mundshëm. Në sektorin e energjisë nuk u krijuar asnjë kapacitet i ri.

- Marrëveshja e Uashingtonit nuk është zbatuar dhe, rrjedhimisht, centrali me gaz nuk u ndërtua.

- Kontrata për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re u anulua dhe shteti është detyruar të paguajë 20 milionë euro penalti.

- Çmimi i energjisë elektrike u rrit disa herë, duke rënduar koston e jetës së qytetarëve.

- Nxjerrja e bizneseve në tregun e hapur energjetik pa krijuar kushtet e nevojshme ka bërë që rreth 1000 kompani të furnizohen me energji rreth tri herë më shtrenjtë se që kanë paguar më parë.

Kjo situatë ka rezultuar me rritje të kostove të prodhimit për bizneset, të cilat janë bartur në çmimet e produkteve, duke rritur kështu koston e shportës për qytetarët. Deficiti tregtar është dyfishuar në pesë vitet e fundit, çka është shenjë se prodhimi vendor nuk ka arritur të konkurrojë me produktet nga jashtë. Struktura e mallrave që importohen reflekton mungesën e prodhimit vendor në mallrat më elementare.

Absolutisht asnjë reformë fiskale nuk është ndërmarrë gjatë gjithë mandatit. Përkundrazi, është ndërprerë dialogu me bizneset dhe janë prekur ligjet bazike ekonomike, duke e përkeqësuar ambientin e të bërit biznes. Sistemi i licencave për biznese në disa sektorë strategjikë është në kaos, duke bërë që shumë biznese të funksionojnë në mënyrë joligjore.

3. Partneritetet janë cenuar, ndërprerja e dialogut strategjik dhe sanksionet kanë bllokuar mbështetjen financiare dhe politike

Asnjëherë Kosova nuk ka qenë më e izoluar se tani. Për më shumë se dy vite vazhdojnë sanksionet nga ana e BE-së, të cilat kanë bllokuar qindra miliona euro për sektorë shumë të rëndësishëm. Pasojat janë edhe politike, pasi është bllokuar progresi i Kosovës drejt BE-së, siç parashihet me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe me Planet Kombëtare Vjetore për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Për herë të parë, partneriteti strategjik Kosovë - SHBA është goditur rëndë. Dialogu strategjik, mekanizmi kryesor i bashkëpunimit politik dhe ekonomik me aleatin tonë më të rëndësishëm, është bllokuar. Si pasojë, bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara është reduktuar ndjeshëm, duke e lënë Kosovën të

izoluar në raport me aleatin që e ka mbështetur në momentet më vendimtare të historisë së saj.

Debatet në Kongresin Amerikan, ku kryeministri i Kosovës përmendet si faktor pengues i bashkëpunimit Kosovë-SHBA, janë alarm serioz për politikën e jashtme të vendit dhe dëshmi e një krize të thellë besimi.

Në të njëjtën kohë, diplomacia kosovare është paralizuar: ambasada pa staf të mjaftueshëm, përfaqësimi në NATO i lënë bosh pas përfundimit të mandatit, dhe në Izrael - një partner strategjik - Kosova vazhdon të përfaqësohet vetëm me të ngarkuar me punë, që nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike. Kjo qasje përbën jo vetëm papërgjegjësi, por edhe nënçmim të hapur të interesit shtetëror dhe aleancave tona strategjike.

4. Bashkëpunimi ndërshtetëror është për keqardhje për shkak të agjendave elektorale Shqiptarët në të dy anët e kufirit Kosovë-Shqipëri po komunikojnë e lëvizin gjithnjë e më shumë, por ka tri vite që nuk ka mbledhje të përbashkëta të Qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës. Në anën tjetër, Shqipëria mban mbledhje të përbashkëta me Qeverinë e Italisë.

Politika përçarëse karshi shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe në Luginë të Preshevës ka krijuar një situatë të paprecedentë. Kosova gjithmonë ka shërbyer si përafëruese dhe udhëzuese e spektrit politik të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut e në Luginë. Në këto vite, po ndodh e kundërta. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut kanë qenë faktor i kryesor në ruajtjen e kursit pro-perëndimor të Maqedonisë së Veriut, duke u përpjekur në të njëjtën kohë të avancojnë pozicionin e tyre politik. Dhe në këtë drejtim janë arritur rezultate të konsiderueshme. Përçarjet e nxituara nga Qeveria e Kosovës kanë shkaktuar regres në këtë aspekt.

5. Dialogu me Serbinë Braktisja e dialogut për njohje reciproke, që kishte nisur në qeverinë paraprake, ka qenë gabimi kapital i Kurtit dhe Osmanit. Ky gabim erdhi nga zhytja e Kurtit dhe Osmanit në labirintet e një dialogu teknik, pa orientim të qartë drejt njohjes reciproke, një dialogu për menaxhim të situatave e jo për përmbjllje të marrëveshjes përfundimtare, një dialogu në kundërshtim me këshillat e aleatëve. Kjo situatë rezultoi me detyrimin e Kurtit dhe Osmanit që të pranojë planin franko-gjerman, aneksin e Ohrit dhe draft-statutin e asociacionit.

Të tria këto dokument janë të dëmshme për Kosovën, pasi:

1. krijojnë një status quo të re, që pamundëson arritjen e

marrëveshjes finale në të ardhmen e afër;

2. legjitimojnë për një periudhë kohore strukturat paralele të Serbisë në Kosovë në arsim e shëndetësi;

3. pranojnë një lloj autonomie për komunitatet me shumicë serbe;

4. nuk e mbajnë Serbinë përgjegjëse për dëmet e shkaktuar ndaj Kosovës; si dhe çështje të tjera problematike.

Në anën tjetër, Kosova po bartë pasoja nga sjellja e papërgjegjshme dhe antishtetërore e Kurtit dhe Osmanit sa i përket Marrëveshjes së Uashingtonit. Investimet madhore në infrastrukturë e energjetikë që burojnë nga kjo marrëveshje nuk kanë ndodhur. Përfitimet e pritura politike nga zbatimi i këtyre projekteve përbëjnë koston kryesore për Kosovën nga kjo sjellje e papërgjegjshme dhe antishtetërore.

6. Çfarë duhet bërë në qeverisjen e ardhshme?

Në qeverinë e ardhshme, hapi i parë është kthimi i normalitetit në qeverisje, kthimi i ligjshmërisë në institucione dhe menaxhimiligjor i buxhetit. Vetëm kjo e ndal kaosin, abuzimet dhe korrupsionin. Auditimi i plotë dhe i thellë i veprimeve ku ka dyshime duhet të jetë i pavarur dhe profesional.

Në politikën e jashtme na duhet aktivitet i fuqishëm lobues për të larguar sanksionet dhe për të filluar dialogun strategjik. Para se gjithash, duhet të tregojmë seriozitet shtetëror në qasjen ndaj partnerëve. Duhet të normalizojmë punën e ambasadave, të emërojmë sa më parë ambasadorët në vendet vakante, duke siguruar se emërohen njerëz profesional dhe me integritet.

Në shëndetësi, duhet të nis menjëherë projekti i zbatimit të sigurimeve shëndetësore. Brenda një viti duhet të mblidhen premiume të mjaftueshme për të nisur një proces gradual dhe të shkallëzuar të pagesës së shërbimeve shëndetësore të qytetarëve përmes sigurimeve shëndetësore derisa të arrihet mbulueshmëria e plotë. Sistemi Informativ Shëndetësor duhet të funksionalizohet për çështje javësh për të vendosur rend në kaosin e gjithë sektorin shëndetësor privat dhe publik, duke integruar të gjithë ata që janë të lidhur me këtë sektor - nga mjeku i përgjithshëm në një shtëpi shëndeti e deri tek kirurgu në QKUK, nga një barnatore në një lokalitet të vogël e deri tek Barnatorja Qendrore, përfshirë këtu kompanitë që merren me tregtinë e barnave. Fondi për modernizim të spitaleve duhet të formohet menjëherë. Struktura e pagave të stafit shëndetësor dhe mbështetës duhet menjëherë të rishikohet për të siguruar paga konkurrense që parandalojnë

migrimin e stafit shëndetësor jashtë vendit dhe largimin e tyre nga institucionet publike tek ato private.

Duhet të kthehet dialogu me arsimtarët për të zhvilluar reformat gjithëpërfshirëse, përfshirë rishikimin e rrjetit të shkollave, digjitalizimin e planprogrameve, trajnimet e mësimitdhënësve, modernizimin e shkollave me pajisje didaktike, ndërlidhjen e shkollave me ekonominë, mbështetjen masive të hulumtimeve në arsimin e lartë, pagesën e stafit arsimor sipas performancës dhe reforma të tjera. Pagat e stafit arsimor në të gjitha nivelet duhet të rriten menjëherë në mënyrë që kuadrot më të mira të qëndrojnë në institucione arsimore. Përzgjedhja e stafit arsimor duhet të standardizohet në nivel vendi përmes kritereve unike dhe trupave në nivel kombëtar që bëjnë përzgjedhjen. Kthimi i garave sportive dhe garave të tjera në shkolla, i klubeve, funksionalizimi i plotë i bibliotekave shkollore dhe shërbime të tjera në nivel të shkollave është imediat për të rritur aktivitetin në kuadër të shkollës dhe të komunitetit. Kalimi në mësimin gjithë ditë duhet të jetë prioritet kombëtar.

Në ekonomi duhet nisur menjëherë dialogun e ndërprerë me biznese. Duhet investuar masivisht në energjetikë dhe infrastrukturë, në atë hekurudhore në veçanti. Duhet të digjitalizohen të gjitha shërbimet administrative karshi bizneseve, në veçanti sistemi i licencave, lejeve dhe tatimeve. Vetëm kjo siguron transparencën dhe eliminon burimet e abuzimeve dhe korrupsionit.

Dialogu social gjithëpërfshirës duhet të nis menjëherë. Sindikatat dhe bizneset duhet të jenë partnerë zhvillimor. Nuk duhet lejuar që paga minimale dhe reformat kryesore të vendosen në mënyrë arbitrare nëpër kabinetet e ministrave pa asnjë konsultim.

Marrëdhëniet me shqiptarët në rajon duhet të normalizohen. Mbledhjet e përbashkëta të qeverive me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut duhet të futen menjëherë në agjendë. Duhet të funksionalizohet menjëherë Zyra për Luginën e Preshevës, që është themeluar me vendim të Qeverisë në qeverinë paraprake, e cila zyrë do të koordinojë gjithë mbështetjen financiare, politike dhe institucionale për shqiptarët në Luginë.

Tri segmentet infrastrukturorë shtesë që lidhin shqiptarët në rajon duhet të nisin menjëherë dhe përfundojnë brenda mandatit: hekurudha Prishtinë-Durrës, rruga Prizren Tetovë dhe autostrada Gjilan-Dheu i Bardhë.

BPV-ja në tremujorin e tretë shënon rritje reale për 3,08%

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor për tremujorin i tretë (TM3) të vitit 2025, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak. Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor janë: Aktivitetet financiare dhe të

sigurimit 8,13%; Ndërtimtaria 7,19%; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike, aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse 4,76%; Bujqësia, pyjet dhe peshkimi 3,42%; Industria përpunuese 3,16%; Informacioni dhe komunikimi 2,95%; Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të

tjera 2,66%; Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, transporti dhe magazinimi; aktivitete të akomodimit dhe shërbimit ushqimor 2,28%; Administrata publike dhe mbrojtja, siguri social i detyrueshëm, arsimi, shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale 1,85%; Industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, gaz, avulli dhe

furnizimi me ajër, furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit 1,32% dhe Aktivitete të pasurive të paluajtshme 0,54%. Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje janë: Formimi i bruto kapitalit 13.1%; Importi i mallrave dhe shërbimeve 7,39%; Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake



dhe IJPSHESH 4,16% dhe Eksporti i mallrave dhe shërbimeve 2,48%. Ndërsa rënie kishin: Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë -1.7%.

AKK-JA THIRRJE BIZNESEVE: TË NDALOHET ÇDO RRIJTJE E PAJUSTIFIKUAR E ÇMIMEVE GJATË FESTAVE TË FUNDVITIT

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Autoriteti i Kosovës i Konkurrencës ka bërë thirrje që të respektohet Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të ndalohet çdo rritje e pajustifikuar e çmimeve gjatë festave të fundvitit. Sipas një njoftimi në rrjetin social në "Facebook" bëhet me dije se me afrimin e festave të fundvitit dhe rritjen e kërkesës për produkte dhe shërbime, Autoriteti i Konkurrencës u bën apel të gjitha bizneseve dhe operatorëve ekonomikë që të përmbahen nga çdo rritje e pajustifikuar e çmimeve, në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. "Rikujtojmë se çdo marrëveshje, bashkërendim apo veprim i njëanshëm ndërmjet bizneseve që ka për

qëllim ose efekt rritjen artificiale të çmimeve, ndarjen e tregut, kufizimin e konkurrencës apo abuzimin me pozitën e përbashkët dominuese, përbën shkelje të rëndë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe është subjekt i sanksioneve ligjore. Festat e fundvitit nuk duhet dhe nuk do të shfrytëzohen për abuzim me konsumatorët, për rritje të koordinuara të çmimeve apo për praktika që cenojnë konkurrencën e lirë dhe të ndershme në treg", thuhet në njoftim. Po ashtu në njoftim thuhet se çmimet duhet të reflektojnë kushtet reale të tregut dhe jo marrëveshje të ndaluara, sjellje spekulative apo shfrytëzim të pozitës së përbashkët në treg. "Në përputhje me Ligjin për



Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti ka kompetencë të inicijojë dhe zhvillojë hetime për shkelje të konkurrencës deri në pesë (5) vite mbropa, përfshirë edhe periudhën e festave të fundvitit. Që nga fillimi i muajit Dhjetor dhe deri në fund të këtij muaji, të gjithë inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës do të jenë çdo

ditë në terren në çdo qytet të Republikës së Kosovës, duke monitoruar me kujdes dhe në mënyrë të vazhdueshme lëvizjet dhe rritjet e çmimeve në treg". AKK-ja u ka bërë thirrje bizneseve që: 1. Të veprojnë në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës; 2. Të shmangin çdo formë të

bashkërendimit të çmimeve apo sjelljeve të koordinuara; 3. Të mos abuzojnë me pozitën e përbashkët ose fuqinë e tyre në treg; 4. Të tregojnë përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe konsumatorëve, veçanërisht në këtë periudhë festive. "Njëkohësisht i inkurajomë konsumatorët të raportojnë çdo dyshim për rritje të pajustifikuar ose të koordinuar të çmimeve, në mënyrë që Autoriteti të ndër marrë veprimet e nevojshme ligjore. Dyshimet e tilla mund të dërgohen edhe përmes emailit zyrtar: info.konkurrenca@rks-gov.net. Respektimi i ligjit dhe i konkurrencës së lirë është detyrim ligjor dhe interes i përgjithshëm për biznese, konsumatorë dhe ekonominë e vendit".

RRITJE E LEHTË E SASISË SË MBETURINAVE INDUSTRIALE NË 2024

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Mbeturinave Industriale (AMI) për vitin 2024. Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tregut të këtij sektori. Sipas të dhënave të Anketës së Mbeturinave Industriale (AMI), sasia totale e mbeturinave

industriale të gjeneruara gjatë vitit 2024 ka arritur në 3 445 593 ton, duke shënuar një rritje prej 1,6%, krahasuar me vitin 2023. Analiza sipas sektorëve të aktivitetit ekonomik tregon se: sektori D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar ka qenë kontribuuesi kryesor në gjenerimin e mbeturinave industriale. Ky sektor ka gjeneruar 2 180 738 ton, që



përfaqëson 63,3% të sasisë totale të mbeturinave industriale të gjeneruara në vitin 2024. Pastaj, sektori C -

Industria përpunuese, me një sasi prej 789 027 ton, ose 22,9% të gjithsej mbeturinave të gjeneruara. Ndërkohë, sektorët e tjerë të industrisë kanë gjeneruar gjithsej 475 828 ton, që përbën 13,8% të sasisë totale të mbeturinave industriale të gjeneruara gjatë vitit 2024. Anketa e Mbeturinave Industriale 2024, u realizua sipas Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike, NACE Rev.2. Kompanitë e

përfshira në anketë janë klasifikuar në sektorët e aktiviteteve, si në vijim: A Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari; B - Xehetari dhe Gurore; C - Prodhim; D - Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar; E - Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim të mbeturinave dhe rregullim toke; F - Ndërtimtari; dhe G-U - sektorët e shërbimeve.

Spanca: Zbatimi i rekomandimeve të auditimit është thelbësor për qeverisje të mirë dhe integritet institucional

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, mori pjesë në tryezën vjetore "Progresi dhe sfidat në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit", organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Tryeza pati për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe avancimin e transparencës dhe llogaridhënies në

institucionet publike. Spanca prezantoi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit nga institucionet dhe theksoi nevojën për mekanizma më të qëndrueshëm të llogaridhënies. Ajo rikujtoi se zbatimi i rekomandimeve të auditimit është thelbësor për qeverisje të mirë dhe integritet institucional. "Zbatimi i rekomandimeve nuk është

vetëm kërkesë formale por është një investim i drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve publike dhe në besimin qytetar ndaj institucioneve", ka thënë Spanca. Auditorja e Përgjithshme tha se aktualisht niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është në nivelin e duhur, prandaj u bëri thirrje institucioneve që të angazhohen më shumë për zbatimin e tyre.



KUSH ËSHTË SUSIE WILES, GRUAJA MË E FUQISHME NË SHTËPINË E BARDHË

Një artikull i gjatë i Vanity Fair hedh dritë mbi rolin kyç të Susie Wiles, shefes së stafit të Shtëpisë së Bardhë, e cila përshkruhet si personi i vetëm që mund të kanalizojë vendimet impulsive të presidentit Donald Trump në mandatin e tij të dytë.

Wiles, një stratege veterane republikane dhe arkitekte e fitores së Trump, shfaqet si figura më me ndikim në administratë, më shumë sesa zëvendëspresidenti JD Vance, sekretari i Shtetit Marco Rubio apo Stephen Miller. Ajo nuk e kontrollon Trump-in, por e lehtëson dhe zbaton vizionin e tij, shpesh duke menaxhuar kriza të mëdha në prapaskenë.

Vanity Fair shkruan për një vit të trazuar të presidencës Trump me:

- zgjerim ekstrem të pushtetit presidencial,
- luftë ndaj karteleve të drogës,
- mbyllje e kufirit jugor,
- sulme ndaj mediave, universiteteve dhe kundërshtarëve politikë,
- falje masive për të dënuarit e 6 janarit,
- dhe akuza për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut

Një nga përplasjet më të forta ka qenë me Elon Musk, i cili drejtoi shkrirjen e USAID-it dhe pezulloi programe jetike humanitare, përfshirë PEPFAR-in për HIV/AIDS. Vetë Wiles pranon se ishte “e tronditur” dhe se u detyrua të ndërhynte për të kufizuar dëmet, ndërsa Trump, sipas saj, nuk hyn në detaje të tilla.

Wiles e përshkruan Trumpin si një njeri me “personalitet alkooliku” e që është i bindur se nuk ka asgjë që nuk mund ta bëjë. Ajo ka një marrëdhënie të ndërtuar mbi besim të fituar dhe është e vetmja që mund t'i flasë drejtpërdrejt, edhe kur nuk bie dakord me të.

Megjithatë, pyetja kryesore që shtron Vanity Fair mbetet: A do ta frenojë ndonjëherë Susie Wiles Donald Trump-in, apo thjesht do ta ndihmojë të shkojë edhe më larg?

Në analizë, përgjigja lihet e hapur, por diçka bëhet e qartë: në Shtëpinë e Bardhë, pushteti real kalon përmes Susie Wiles-it.

Susie Wiles dhe mandati i dytë i Trump

Në pjesën e dytë të artikullit, Vanity Fair përshkruan se si



Susie Wiles ka ndihmuar Donald Trump të ndërtojë një kabinet ekstremisht ideologjik, të mbushur me figura që kritikët i shohin si ndër më të papërgatiturit në historinë amerikane.

Mes emrave kyç janë:

- Pete Hegseth, sekretar i Luftës (ish-Mbrojtjes),
- Kash Patel, drejtor i FBI-së,
- John Ratcliffe, drejtor i CIA-s,

- Pam Bondi, prokurore e përgjithshme,
- Tulsi Gabbard, drejtoreshë e Inteligjencës Kombëtare,
- Kristi Noem, në krye të Sigurisë Kombëtare.

Wiles i quan ata “kabinet i klasit botëror”, të zgjedhur për të përballur atë që ajo e sheh si “shtetin e thellë”, veçanërisht kompleksin ushtarako-industrial.

Deportime masive dhe gabime...

Në mars 2025, pas aktivizimit të Alien Enemies Act, administrata Trump deportoi qindra emigrantë venezuelianë drejt një burgu famëkeq në El Salvador, pavarësisht urdhrave gjyqësorë. Shumë prej tyre nuk kishin precedentë penalë, ndërsa të paktën një u

deportua gabimisht.

Wiles pranoi se procesi kishte dështime serioze, por mbrojtja linjë e ashpër: sipas saj, vetëm rastet e dyshimta duhej të rishikoheshin. Megjithatë, ajo nuk ishte në gjendje të shpjegonte raste si ai në Luiziana, ku dy nëna u deportuan bashkë me fëmijët e tyre shtetas amerikanë, përfshirë një fëmijë 4-vjeçar me kancer në fazë terminale.

Luftë tregtare dhe kaos ekonomik

Në prill, Trump shpalli “Ditën e Çlirimit” dhe vendosi tarifa masive ndaj partnerëve tregtarë, duke i quajtur një fitore ekonomike, edhe pse ndikimi real ishte mbi konsumatorët amerikanë.

Wiles e pranon se procesi ishte kaotik dhe se këshilltarët ishin thellësisht të ndarë. Ajo tentoi ta ngadalësonte presidentin, por pa sukses. Tarifat shkaktuan panik në tregje, rënie të bursës dhe talljen publike “TACO – Trump Always Chickens Out”, pasi Trump u tërhoq përkohësisht.

Sipas një sondazhi të Harvardit, 56% e amerikanëve mendojnë se tarifat e Trump-it kanë dëmtuar ekonominë.

Garda Kombëtare në qytete

Gjatë verës, Trump dërgoi Gardën Kombëtare në disa qytete të drejtuara nga demokratët, përfshirë Los Angeles-in dhe Washington-in, duke shpallur emergjencë kriminale.


Wiles e mbrojtja vendimin si një “shtysë vitaminash” për rendin dhe sigurinë, por kritikët e cilësuan si të paligjshëm dhe kërcënim për demokracinë.

Kur u pyet nëse Trump mund të përdorë ushtrinë për të ndikuar apo ndaluar zgjedhjet, Wiles reagoi ashpër:

Është krejtësisht e pavërtetë!

Megjithatë, Vanity Fair ngre pyetjen kyçe: A po i shtyn Trump dhe ekipi i tij kufijtë kushtetues në një pikë të pakthyeshme?

Wiles thotë se Trump do t'u bindet vendimeve të gjykatave, por parashikon se administrata do të fitojë në fund...



Rooney më fjalë të mëdha për Xhakën

LONDËR, 16 DHJETOR - Ylli i dikurshëm anglez, Wayne Rooney, ka insistuar se kapiteni i Sunderlandit, Granit Xhaka, është “transferimi më i mirë i sezonit në Premier League”. Sulmuesi ikonik i Manchester Unitedit ka dhënë këtë vlerësim pasi Xhaka e udhëhoqi Sunderlandin drejt

fitores në derbin e zjarrtë ndaj Newcastle Unitedit. Në fakt ishte vetëm edhe një paraqitje tjetër impulsive për Xhakën, të cilin Rooney e ka vlerësuar lartë, sërish. Duke folur në “The Wayne Rooney Podcast”, legjenda angleze, ka thënë se në fillim të sezonit është frikësuar për

Sunderlandin por pastaj shtoi se pronari dhe trajneri kanë bërë një punë të detajuar. “Xhaka duhet të jetë transferimi i stinorit. Ai ishte gjithnjë lojtar i mirë. Kam menduar se duke shkuar në Sunderland do të vuajë dhe nuk do të jetë transferim i mirë, por ai ishte i jashtëzakonshëm.

Është aftësia e tij për të diktuar lojtarët dhe për të qetësuar lojën. Ai ishte brilant”, ka theksuar Rooney. Shumë ish-futbollistë dhe ekspertë të njohur në Angli kanë vlerësuar lart Xhakën, i cili është transferuar te Sunderlandi nga Bayer Leverkuseni.



PRESIDENTI I FFK-SË DHE AI I FIFA-S DISKUTOJNË PËR ZHVILLIMIN E FUTBOLLIT NË KOSOVË

DOHA, 16 DHJETOR - Në Doha, në prag të finales së Kupës Interkontinentale midis PSG dhe Flamengo, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka takuar presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino. Ademi ka thënë se me Infantinon ka biseduar për zhvillimin e futbollit në Kosovë.

“Një bisedë e frytshme për zhvillimin e futbollit në Kosovë dhe për projektet që kemi në plan për të ardhmen. Është gjithmonë motivuese të ndash vizionin për futbollin me drejtuesit e futbollit ndërkombëtar. Do të vazhdojmë thellimin e bashkëpunimit për të

rritur standardet dhe mundësitë për talentet tona. Futboli ynë po ecën përpara me mbështetjen e UEFA-s dhe FIFA-s”, ka shkruar Ademi në rrjetet sociale. Kujtojmë se Infantino ka raporte të mira me FFK-në dhe është një prej miqve me të mirë të peridentit Ademi.

KOSOVA BËHET ANËTARJA E 154-t E FEDERATËS NDËRKOMBËTARE TË GOLFIT

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Federata e Golfit e Kosovës ka shënuar një moment historik duke u pranuar zyrtarisht si anëtarja e 154-të e Federatës Ndërkombëtare të Golfit (International Golf Federation - IGF). Ky pranim përfaqëson një hap të rëndësishëm për zhvillimin dhe ndërkombëtarizimin e sportit të golfit në Kosovë, njofton Federata e Golfit e Kosovës. Anëtarësimi në IGF i hap rrugë Kosovës për pjesëmarrje në gara dhe

aktivitete ndërkombëtare, përfshirë edhe evente të mbështetura nga lëvizja olimpike. Po ashtu, ky status i ri kontribuon në forcimin e strukturave sportive, rritjen e bashkëpunimit me federata të tjera dhe krijimin e mundësive të reja për sportistët kosovarë. Ky sukses dëshmon përkushtimin dhe punën e vazhdueshme të Federatës së Golfit të Kosovës në ndërtimin dhe promovimin e këtij sporti, si



dhe përpjekjet për ta përfaqësuar vendin denjësisht në arenën ndërkombëtare. Pranimi në Federatën së Golfit është një tjetër hap përpara për

sportin kosovar dhe një dëshmi se Kosova po vazhdon ta zgjerojë praninë e saj në organizatat më të rëndësishme sportive botërore. “Po ashtu, ky triumf nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë, miqve të sportit të golfit kudo në botë dhe kontribuesve vendorë që me profesionalizëm e pasion ngritën këtë projekt në nivelin e duhur. Faleminderit IGF për besimin. Faleminderit secilit sportist, trajner, administrator,

vullnetar, biznes dhe mbështetës të kauzës sonë ndër vite. Sot Kosova nuk është vetëm një vend që luan golf. Sot Kosova është një vend që përfaqëson golfin në arenën ndërkombëtare. Ky është fillimi i një kapitulli të ri: pjesëmarrja në garat botërore, mundësia e përfshirjes në ciklet olimpike, forcimi i infrastrukturës vendore, zhvillimi i talenteve të rinj dhe afirmimi i Kosovës si një destinacion serioz sportiv”, ka njoftuar Federata e Golfit e Kosovës.

SOT DHE NESËR LUHEN NDESHJE INTERESANTE NË SUPERLIGËN E KOSOVËS NË BASKETBOLL

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Sot (e mërkurë) dhe nesër (e enjte) do të zhvillohen ndeshje interesante në kuadër të xhiros së 12-t në Superligën e Kosovës në basketboll. Sot në program takime tejet interesante, ku dueli që spikat është ai në mes

të Vëllaznimit dhe Rahovecit, skuadrave që do të mundohen të mbijetojnë këtë sezon në Superligë. Të dy skuadrat janë përforcuar dhe kërkojnë fitore në këtë takim tejet interesant, që zhvillohet në palestrën “Shani Nushi”.

Dueli tjetër zhvillohet në palestrën “Karagaçi”, ku Peja do të jetë nikoqire e Sigal Prishtinës. Si verdhezinjtë, po ashtu edhe bardhekaltrit renditen në pjesën e epërme të tabelës, me Pejën që është e dyta, ndërsa Prishtina e katërta.

Edhe takimet e nesërme janë tejet sfiduese, ku dueli më interesant pritet të jetë ai në mes të Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit. Ylli nuk po kalon formë aspak të mirë këtë edicion, ku zë vendin e shtatë në tabelë, apo të parafundit,

ndërsa Bashkimi vazhdon të jetë lider i Superligës. Dueli i fundit është ai në mes të Trepçës dhe Borës, që do të zhvillohet në palestrën “Minatori”. Të gjitha takimet e xhiros së 12-të zhvillohen nga ora 18:45.

Zidane arrin marrëveshje me Francën?

Paris, 16 dhjetor - Zinedine Zidane është afër realizimit të ëndrrës së tij. Sipas burimeve të Fabrizio Romanos, Zidane ka arritur marrëveshje verbale me Federatën Franceze të Futbollit. “Sky Sports” po

ashtu ka raportuar për marrëveshjen e Zidanet me Francën. Përzgjedhësi aktual i Francës, Didier Deschamps, do të largohet pas Kupës së Botës 2026. Zidane është konsideruar prej

kohësh si favorit për ta drejtuar Francën e udhëhequr nga Kylian Mbappe. Zidane nuk ka punuar si trajner që nga largimi i tij në vitin 2021 nga Real Madridi. Ai fitoi Ligën e Kampionëve tre herë

rresht me Realin. Ka raportime po ashtu se francezi mund të bëhet trajner i përkohshëm i Realit. Trajneri aktual i Realit, Xabi Alonso, po përballlet me kritika pas rezultateve të fundit.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “APA COM” Sh.p.k., Ramun, Komuna Pejë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për për fabrikën e prodhimit të kubezave, pllakave dhe elementeve të betonit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.02.2026 në ora 10:00 në SHFMU “H axhi Zeka” në Zahaq të Pejës, do të organizohet debat publik nga “APA COM” Sh.p.k., Ramun, Komuna Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

Zoom: <https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “APA COM” Sh.p.k., Ramun, Komuna Pejë, për Pëlqim Mjedisor, për fabrikën e prodhimit të kubezave, pllakave dhe elementeve të betonit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Rec Kos” Sh.p.k., Komuna Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Qendrën e grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshe.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.02.2026 në ora 10:00 në SHFMU “Luigj Gurakuqi” në fshatin Sankoc të Drenasit, do të organizohet debat publik nga “Rec Kos” Sh.p.k., Komuna Drenas, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

Zoom:<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Rec Kos” Sh.p.k., Komuna Fushë Kosovë, për Pëlqim Mjedisor, Qendrën e grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshe.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Hexagon Consulting Group” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811582966 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Hexagon Consulting Group” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811582966 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Hexagon Consulting Group” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811582966 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sadije Musa shpall të pavlefshme dëftesën e plotë Sh.F.M.U. “Yll Morina” Gjakovë.

- Arbër Januzaj nga Dujaka Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Fan S. Noli” Dujakë Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Sami Koca shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Drenica” Polac Skenderaj.

- Vehdi Sejdiu B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik: 810561606.

- N.P.T. “Boletini Tours” shpall te pavlefshme arkën fiskale En11001083 me nrf 811306275.

- “All Star Sport Bar” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më nr. Unik Identifikues: 811847394.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ APC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fábrica de Bebidas Gaseosas Salvadinas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi S.p.a. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Foz de LIMA Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L Lebanon, Sales
- ★ Koteln Československo a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Osi Zolal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Puritas Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

